



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201400276/10

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** *Rekomandohet rikthimi në detyrë i shtetasit A. G.*

**Drejtuar:** **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**  
Z. Artur Zoto

**TIRANË**

*I nderuar Z. Zoto,*

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi A. G., ish punonjës i policisë të burgjeve, i cili pretendon se është liruar në mënyrë të padrejtë nga detyra. Detyra e fundit që ai ka kryer ka qena ajo e N/inspektorit në IEVP Korçë. Sipas Urdhërit Nr.2414/1, datë 05.03.2014 të DPBurgjeve, motivacioni i lirimit nga detyra është "*mosparaqitja në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 7 ditë*". Sipas A. G. ky motivacion nuk është i vërtetë pasi ai ka munguar në punë për arsye shëndetësore e vërtetëtuar nga raporti i paaftësisë së përkohëshme në punë. Dhënia e masës disiplinore nuk është bërë sipas procedurës duke mos i dhënë atij mundësinë për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

Për verifikimin e kësaj ankese i jemi drejtuar disa herë me shkresë IEVP Korçë për të na vënë në dispozicion praktikën e ndjekur për largimin nga detyra të punonjësit A. G. si dhe për të na dhënë shpjegime lidhur me pretendimin e tij. Në përgjigjen që morëm thuhet se, A. G. është transferuar me detyrë nga IEVP Kukës në IEVP Korçë dhe megjithëse ai është njoftuar për transferimin, nuk është paraqitur në detyrë. Ndërsa praktika e largimit nga detyra që na është vënë në dispozicion përmban vetëm disa raport shërbime, në të cilat raportohet se, A. G. nuk është paraqitur në detyrë për tre ditë(dt.24/25/26.02.2014).

Nga analiza në tërësi e legjislacionit që përcakton rregullat për largimin nga detyra të punonjësve të policisë së burgjeve dhe dokumentacioni që na është vënë në dispozicion, rezulton se, A. G. është larguar nga detyra në kundërshtim me ligjin. Akti nënligjor që përcakton rregullat dhe procedurat për dhënien e masave disiplinore është Rregullorja "*Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajtimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve*" miratuar

me Urdhërin nr. 3125/1, datë 04.09.2009 të Ministrit të Drejtësisë. Referuar nenit 49/2 të kësaj Rregulloreje, evidentimi i shkeljeve disiplinore nga punonjësit e policisë bëhet me shkrim. Në dokumentacionin që na ka dërguar IEVP Korçë është raportuar vetëm për tre ditë mungesë në punë të shtetasit A. G. dhe jo për shtatë ditë. Gjithashtu nuk janë respektuar procedurat për dhënien e masës disiplinore të parashikuara në nenin 37/1 të Ligjit Nr. 10032, dt. 11.12.2008 "*Për Policinë e Burgjeve*" dhe në nenet 54-61 të Rregullores (vënia në dijeni me shkrim e punonjësit për shkeljen e konstatuar, dëgjimi i tij, e drejta për tu mbrojtur etj.).

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*"

### **J U R E K O M A N D O J M Ë:**

Rikthimin në detyrë të shtetasit A. G.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi si dhe na dërgoni fotokopje të konstatimeve të mjekut specialist dhe rekomandimeve të tij.

*Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

Në Mungesë dhe me Porosi

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**